

UDHËZIM
Nr. 6, datë 6.4.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 41, DATË 8.12.2009 “PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E NJOHJES SË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 37 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Titulli i udhëzimit nr. 41, datë 8.12.2009 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për procedurat dhe kriteret e njohjes së diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Për procedurën e njohjes zyrtare dhe njehsimit të diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë”.

II. Shkronjat “c” dhe “d” të pikës 1 të udhëzimit nr. 41, datë 8.12.2009 revokohen.

III. Pika 2.2 e udhëzimit nr. 41, datë 8.12.2009 ndryshon si më poshtë vijon:

“Dokumentet e përcaktuara në pikën 2.1 të këtij udhëzimi duhet të jenë dokumente origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentet e shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 2.1, për shtetasit e huaj, duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar, si edhe të noterizuara.

Dokumentet e shkronjave “b” dhe “c” të pikës 2.1, duhet të jenë të pajisura me vulën *Apostille*. Në rastet kur kjo vulë mungon, ndiqet procedura e përcaktuar në pikën 3.2 të këtij udhëzimi.”.

IV. Pika 3.4 e udhëzimit nr. 41, datë 8.12.2009 ndryshohet si më poshtë:

“3.4 Komisioni i njohjes pezullon procedurën e njohjes për raste të veçanta kur ka dyshime mbi vërtetësinë e dokumenteve shkollore ose kryerjen e programit të studimit të pretenduar dhe përcakton afatet dhe masat për mbylljen e procedurës.”.

V. Në pikën 4.3 të udhëzimit shtohet kjo fjali: “SENJOD në bazë të vendimit të komisionit të njohjes përgatit vërtetimin e njohjes dhe njehsimit, për çdo aplikim.”.

VI. Pika 4.4 e udhëzimit ndryshohet si më poshtë:

“4.4 Në përfundim të procedurës, aplikantit i lëshohet një vërtetim njohjeje dhe njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, jo më vonë se një javë nga përfundimi i procedurës. Vërtetimi nënshkruhet nga kryetari i Komisionit të Njohjes së Diplomave dhe Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Format i vërtetimit të njohjes dhe njehsimit, bashkëlidhur shtojca nr. 1, përmban këto elemente:

- a) emri, atësia dhe mbiemri i kandidatit;
- b) institucionin e arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën;
- c) shtetin përkatës;
- d) kohëzgjatjen e programeve të studimit;
- e) titullin e diplomës;
- f) emërtimin e programit të studimeve të kryera shoqëruar me kreditet e përfituata sipas sistemit ECTS (European Credit Transfer System-Sistemi Europian i Transferimit të Krediteve), në ato raste kur është e mundur të përcaktohet në bazë të të dhënave të suplementit të diplomës ose listës së notave.
- g) njehsimin e diplomës përkatëse sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

VII. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe e Kërkimit Shkencor, si dhe Komisioni i Njohjes së Diplomave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj